



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES SOLEMNE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 5 MARS 2018**

**SA SVEĆANE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 5. MARTA 2018. GODINE**

**MARS - MART  
2018**

## **Rendi i ditës**

1. Shënimi i 20-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

## **Dnevni red**

1. Obeležavanje 20-godišnjice Epopeje Oslobodilačke Vojske Kosova

**Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
E nderuara familje e komandantin legjendar Adem Jashari, baca Rifat,  
Familje të dëshmorëve të kombit,  
I nderuar kryeministër i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj,  
Të nderuar ish-komandantë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe bartës të institucioneve,  
Të nderuara medie,  
Mysafirë,  
Organizata joqeveritare,  
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,  
Të nderuar përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare,  
Të nderuar ambasadorë dhe përfaqësues të misionëve diplomatike në Kosovë,  
Të nderuara zonja dhe zotërinj të pranishëm,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Mirë se keni ardhur në seancën solemne të Kuvendit të Republikës së Kosovës me rastin e shënimit të 20-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!

Të nderuar të pranishëm,  
Më lejoni që me rastin e shënimit të 20-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të ju drejtohem me një fjalë rasti:

Të nderuar të pranishëm,  
Familja e komandantit legjendar Adem Jashari, baca Rifat,  
Familje të dëshmorëve,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Kabinet qeveritar,  
Kryeministër i Republikës së Kosovës,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Jemi mbledhur sot në këtë seancë të veçantë, në nderim të njërës prej sakrificave më të mëdha të popullit tonë për liri e pavarësi: sakrificës së Familjes Jashari nga Prekazi dhe Kryeheroit të Kosovës - Komandantit Legjendar, Adem Jashari.

Vitet po kalojnë, por kujtimi për 5 marsin e vitit 1998 mbetet monument i përjetshëm në zemrat e mbarë kombit tonë.

Mbetet dhembja dhe krenaria jonë kombëtare, njëkohësisht.

Atë ditë në Prekaz u ndryshua historia dhe epokat.

Epokës së pritjes dhe jetës së zyrtë të nënshtrimit i erdhi fundi.

Nisi epoka e kryengritjes, epoka e ballafaqimit me të keqen, e triumfit mbi të keqen.

Epoka e çlirimit përfundimtar të Kosovës nga robëria njëshekullore.

Epoka e lëvizjes më të lavdishme që ka krijuar populli ynë në histori: Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Të nderuar të pranishëm,  
Sakrificat e Adem Jasharit dhe Familjes së tij është rast unik në historinë e njerëzimit.

Mesazhi i saj u flet shekujve dhe gjithë popujve: Asgjë nuk është më e çmueshme sesa liria.

Ngjarjet e 5, 6 e 7 marsit të vitit 1998 në Prekaz nxorën para gjithë botës të vërtetën e madhe të Kosovës:

Në njërën anë, e kishim regjimin e egër serb të gatshëm për çdo lloj terrori, vetëm që të mbajnë nën sundim Kosovën. E në anën tjetër, popullin e saj, që kishte vendosur t'i jepte fund njëherë e përgjithmonë robërisë.

Adem Jashari besonte se ëndrra për liri ishte më e fortë se terrori. Dhe, historia i dha të drejtë atij.

Atë ditë, në Prekaz nisi fillimi i fundit të Serbisë në Kosovë.

Ëndrra e Adem Jasharit dhe e mijëra dëshmorëve të Kosovës u bë realitet.

Të nderuar të pranishëm,  
Zonja dhe zotërinj,  
Në këto 20 vjet, Kosova ka shënuar të arritura të mëdha. Edhe skeptikët më të mëdhenj nuk mund t'i anashkalojnë ato.

Në përvjetorin e 10-të të rënies së Adem Jasharit, Kosova e shpalli pavarësinë e saj.

Sot, ne jemi një shtet demokratik:

Me standarde të larta të lirive dhe të drejtave të qytetarëve.

Faktor i paqes dhe stabilitetit në rajon.

Për herë të parë, si komb i rreshtuar drejt.

Partner i qëndrueshëm i Aleancës Veriatlantike.

Dhe, të përkushtuar në rrugën e integriteteve evropiane.

Natyrisht, pjesë e rrëfimit tonë të suksesit janë edhe sfidat e mëdha që kemi përpara, sidomos ato të zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve. Nisur nga kjo, konsideroj se në këtë ditë të madhe për kombin tonë, pyetja nuk është se çfarë bënë dëshmorët për Kosovën?

Secili nga ne, i madh e i vogël, e di përgjigjen në këtë pyetje: Ata e dhanë jetën që ne të jemi të lirë.

Nuk ka akt më të lartë patriotik që dikush mund të bëjë për vendin e tij sesa ky.

Por, sot shtrohet një tjetër pyetje: Çfarë po bëjmë ne të gjallët për Kosovën?

A jemi duke i kryer detyrat tona? A jemi duke e përmbushur siç duhet vullnetin e qytetarëve?

A jemi duke e respektuar veten tonë, shtetin tonë? A jemi duke punuar për të ardhmen e fëmijëve të këtij vendi?

E vërteta është se kemi nevojë për një kthesë morale në mentalitetin dhe sjelljen tonë politike.

Të mendojmë më shumë për qytetarin. Ta pranojmë faktin se jemi në demokraci dhe nuk ka rrugë tjetër të ecjes përpara, përveç rrugës së komunikimit, kompromisit e konsensusit të përbashkët për interesat e vendit dhe të qytetarëve.

Besoj fuqishëm se nuk ka hendeqe të pakapërcyeshme ndërmjet nesh. Ne nuk jemi këtu për t'i dëshpëruar qytetarët, por për t'u dhënë atyre shpresë dhe argumente se ky vend është në rrugën e duhur dhe ka të ardhme të sigurt.

Ne do ta bëjmë këtë.

Natyrisht, së bashku, të udhëhequr nga amaneti i dëshmorëve dhe ëndrrat e fëmijëve të Kosovës për një të ardhme të sigurt dhe dinjitoze në atdheun e tyre.

I nderuar dhe i përjetshëm qoftë kujtimi për Adem Jasharin, Familjen e tij dhe gjithë dëshmorët e lirisë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Tani e ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Ramush Haradinaj, për një fjalë rasti.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** Të dashura familje dëshmorësh, heronjsh, familje të martirëve,  
Shoqata të dala nga lufta,  
Përfaqësues të familjeve të kategorive të lirisë,  
E nderuara Familje Jashari, i dashur bacë Rifat Jashari,  
I nderuar kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli  
Të nderuar deputetë, Kabinet qeveritar, medie, kor diplomatik  
Qytetarë të Kosovës, shqiptarë kudo që jeni.

Një jetë na është dhënë të gjithëve dhe një Atdhe!

Disa nga më të mirët tanë zgjodhën që jetën t'ia dhurojnë atdheut. Përpara frikës e zgjodhën rezistencën, përpara poshtërimit e zgjodhën kryengritjen, përpara dorëzimit e zgjodhën shpresën.

Familja Jashari e përshpejtoi kohën, i përmbysi shekujt, i ndërroi epokat dhe mbeti përjetësisht në kujtesën e kombit si rast unik i flijimit për liri e dinjitet.

Historia thonë se është mësuesi më i mirë për aq sa ajo nuk na përsëritet.

Dhe, jam i bindur se ajo nuk do të përsëritet, përderisa jemi unikë dhe nuk kemi frikë ta shohim të sotmen dhe të nesërmen në sy.

Sot, kur po e shënojmë 20-vjetorin e Epopesë së UÇK-së dhe rënies së Jasharëve, komandantit legjendar Adem Jasharit, Hamzës dhe 21 anëtarëve të familjes së ngushtë të Shaban Jasharit, dhe gjithë të rënëve për liri, duhet të shohim së pari ku jemi në raport me ndërtimin e shtetit modern, në raport me kategoritë e lirisë, familjet e dëshmorëve e të heronjve dhe në raport me invalidët e luftës.

Të shohim se sa ne politikanët u kemi qëndruar afër atyre familjeve në përballje me jetën e me të vërtetën.

Historia na mëson që të lidhemi rreth idesë së Madhe të Shtetit Sovran si kulm shtëpie për të gjithë ne. Për këtë shtëpi ranë në altarin e lirisë me buzëqeshje në fytyrë dhe krenari në shpirt bijat dhe bijtë e zgjedhur të atdheut.

Njëzet vjet pas flijimit heroik të familjes Jashari për lirinë e vendit duhet të reflektojmë për të djeshmen, të sotmen dhe rrugën tonë drejt të ardhmes.

Brezat e rinj të shqiptarëve dhe miqtë e Kosovës na porositin që ta ndërtojmë paqen për të gjithë, sepse ajo është më e vështirë se lufta, pra ta ndërtojmë një Kosovë të denjë për të gjithë qytetarët, të tillë çfarë e ëndërruan dëshmorët dhe heronjtë e Kosovës, pa dhunë e shtypje, pa padrejtësi e nëpërkëmbje.

Ne, kemi ecur njëzet vjet në liri dhe të arriturat janë të dukshme.

Por, liria ka dimensione tjera: Liria për të pasur një kulm mbi krye, një punë për secilin që dëshiron të punojë, një shtet, pasaportën e të cilit nuk e shohin të tjerët me dyshim e shumëçka tjetër.

Prandaj, nga këtu i ftoj të gjithë shqiptarët, gratë dhe burrat, partitë politike dhe liderët e tyre, si dhe komunitetet me të cilët bashkëjetojmë, për unitet institucional dhe kohezion shoqëror për t'i mbrojtur idealet e lirisë, për ta ndërtuar Kosovën e së ardhmes.

Kosovën ku të gjithë frymojnë lirshëm

Kosovën shtëpi e të gjithëve, pa dallim

Kosovën, ku qytetarët e gëzojnë të drejtën e natyrshme të lëvizin lirshëm.

Kosovën, pjesë e familjes evropiane.

Kosovën, pjesë e NATO-s dhe e OKB-së.

Ne synojmë një ekonomi prosperuese, si vlerë e shtuar e demokracisë, duke i shfrytëzuar në mënyrë racionale resurset natyrore që na i ka falë Zoti.

Investimi mbi një miliardësh në energji e siguron pavarësinë energjetike të vendit, ndërsa 2018-ta do të jetë Vit i Trepçës.

Do ta arrijmë një edukim cilësor që studentët tanë të konkurrojnë me dije në tregjet e punës në Bashkimin Evropian dhe më gjerë.

Do të kemi shërbime shëndetësore moderne dhe ambient të shëndoshë.

Dhe, ajo më kryesorja, shteti ynë do të jetë shteti i së drejtës.

Sot, pra, me respekt përulemi para të rënëve për liri.

Lavdi e përjetshme për të gjithë gratë e burrat, për të gjithë të rënë për liri të atdheut!

Lavdi e përjetshme për komandantin legjendar Adem Jashari dhe Familjen Jashari!

Zoti e bekoftë kombin tonë!

KRYETARI: Të nderuar të pranishëm,

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe me këtë i përmbylli punimet e kësaj seance solemne me rastin e shënimit të 20-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*